



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 123

Prishtinë, më 29.7.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Mungoi : Afërdita Berisha-Shaqiri. Sevdije Lama dhe Boban Todorović

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.7.2013;
3. Raporti gjashtë mujor i punës së komisionit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshim, ku si pikë e rendit të ditës u shtua shqyrtimi i Projektligjit për Fshatin Zymi i Hasit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.7.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.7.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Fshatin Zymin i Hasit

Nait Hasani, pasi e hapi debatin për këtë projektligj i ftoi deputetët që të marrin fjalën. Deputeti Daut Haradinaj kërkoi që të bëhet transkript i këtij debati.

Liburn Aliu ky projektligj nuk bënë të procedohet më tutje sepse është i një logjike dhe konceptualisht i njëjtë me Ligjin për Fshatin Hoçë e Madhe. Na e dimë se si ka kalu Ligji për fshatin Hoçë e Madhe, na i dimë presionet që na u kan bërë si për qendrën Historike të Prizrenit ashtu edhe për Ligjin Hoçë e Madhe si prej Pieter Feith-it, kryeministrit Hashim Thaçi, ministrit Dardan Gashi, zv.kryeministrit Hajredin Kuçi, nëpër ato mbledhje që i kemi pasur bashkë e dimë mirë qysh kanë shkuar dhe mendojmë ky projektligj tash veq sa e përforcon edhe më shumë Ligjin për Hoçën e Madhe. Kundërshtimet që i kemi bërë na në atë projektligj megjithatë ne e kemi lënë derën hapur herëdokur në të ardhmen me mujt me i rishiku sepse janë bërë nën presion, tash ky projektligj e forcon atë Ligjin e Fshatit Hoçë e Madhe. Në anën tjetër edhe për ka mënyra se si është i përpiluar Ligji për Hoçën e Madhe që ngjashëm është edhe ky ligj në të njëjtin koncept i përngjan atij krejt vetëm se ndryshon kur bëhet fjalë për Zym. Nuk është mënyra e drejt e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mendojmë që mbrojtja e trashëgimisë kulturore nuk bëhet duke krijuar zona të veçanta të cilat janë nën administrim të fshatit ato janë që është të profesionistëve të fushës dhe mendoj që është krejtësisht i pa nevojshëm tu e pasur parasysh cilat kanë qenë motivet që e kanë prurë projektligjin për Hoçën, është krejtësisht motive që bien në kundërshtim me çfarëdo rregulle normale, nuk ish dasht na tash me bo edhe ligjin për fshatin Zym i Hasit me përjashtim se banoret e fshatit Zym kanë me mendu që po bëhet diçka interesante me ta, me kohën ka mu pa që nuk ka ndonjë vlerë të madhe.

Nait Hasani faleminderit fjalën e ka Daut Haradinaj.

Daut Haradinaj fshati Zym i Hasit është një fshat që është i rallë, është i shtrirë në një terren 12 kilometra në perëndim të Prizrenit në kufi me Shqipërinë, ka qenë qendër historike e banuar me shqipëtar, ka qenë qendër administrative 500 vjet e larguar prej pushtimit osman i fortifikum është me kala, është një rrugë, është një vend që une mendoj që Kosova dhe shoqëria e Kosovës e ka për detyrë që me shpall zonë të vecant sikurse qendrën historike të Prizrenit edhe mendoj që ma shumë vlera ka ky vend edhe nuk krahasohet me Hoçën, seni i parë. Seni i dytë është abetarja e parë e gjuhës shqipe në vitin 1900 e shtypun në Zym dhe e implementume në Zym dhe e hapur shkolla në Zym të cilën kam me ju sjellë krejt deputeteve mi pa. Seni i tretë është vendi i Shtjefën Gjeçovit njëri prej veprimtareve të mëdha që është prej shkrimtareve që në vitin 1926 Serbia e ka pushkatu në hyrje të fshatit. Është vendi i parë ku figuron rreth 500 vjet që ka pasur gjurmë arkeologjike të vërteta të toponimeve shqiptare origjinale, është i përbërë dhe i banuar prej shqiptarëve por i përzier në fe, ka shqiptar dhe katolik. Ligji i ka 10 nene, kosto buxhetore nuk ka, parashihet që të implementohet prej Komunes së Prizrenit, në rast se Rugova e Hasit bëhet komunë vetëm i kalojnë përgjegjësit nivelit të dytë që nuk e pengon përkundrazi kjo e nis, ndërsa ndarja ose që po flasim për Hoçën aty kemi të bëjmë me kishën ortodokse serbe, ndërsa projektligjin për Zym të Hasit nuk përmendet kisha katolike shqiptare as xhamia islamike arabe po përmendet thjesht zonë e mbrojtur, përgjegjësitë e kufizime të këtij komuniteti nënkupton rregullimin, administrimin, mirëmbajtjen organizimin, thjesht funksionimin sa më të mirë edhe pse jo në një të ardhme të afërt edhe me qu në mbrojtje të UNESCO-s, për shak se ka vlera të mëdha të trashëgimore, kulturore, historike etj. d.m.th nuk guxon me pasë paralele në mes Zymit dhe Hoçës po aq më pak kur flasim për qendrën e Prizrenit. Nëse flasim se i përngjet natyrisht se çdo ligj në Kosovë bazohet në ligjet paraprake ose vendimet paraprake të cilat i ka nxjerr Parlamenti i Kosovës. Mendoj që është i domosdoshëm edhe thjesht gjithkush ka drejtën që të jap mendimin apo vlersimin e vetë, po në fund të fundit edhe nëse nuk kalon gjithkush duhet ta mbaj përgjegjësin e vet, nëse ja hekim këtë të drejtë këtij fshati, nëse e dimë që prej këtij vendi kanë dalë edhe Papë, lider të mëdhenjë të gjuhës dhe kulturës shqipe, mbrojtës të mëdhenjë të historisë, në këtë vend ka pasur vend komunë ku ka udhëhequr një regjion shumë të madhe në Rugovë të Hasit, në dy Rugova të Hasit në Rugovën e Gjakovës dhe Rugovën e Prizrenit, edhe tani na po ju hijmë në hak atij komuniteti në rast se lojmë në duart e atyre njerzve që sot mundësit i kanë shumë të kufizuar për mi mbrojtje kjo është arsyeja. Në rast që pretendojmë

që politikisht do ta merr dikush ndonjë votë me këtë projektligj, unë po ju siguroj juve se aty banojnë vetëm 30 anëtar, nuk ka banim janë nëpër Kroaci nëpër diasporë, vendi si vend është shumë i veçantë.

Liburn Aliu nuk du me lidh motivin që është për vota, nuk du me hy andej pari. Ju po thoni që në fund duhet të jetë nën mbrojtje të UNESCO-s, folët për histori për ato që krejt që nuk i konteston kurkush edhe ato nuk janë temë, nuk është temë që ndonjë Papë ka mujt me dalë prej aty, ka vlera ato nuk janë tema në këtë rast, temë është qysh duhet të trajtohen ato sepse kur i bënë ato temë i bie që ai që e kundërshton projektligjin po i kundërshtojka ato të vërtetat, ajo nuk është ashtu, nëse ka vlera në fshat historike, kulturore etj. Kundërshtimi i projektligjit, nëse ti përpiqesh me nxjerr që ai që kundërshton Projektligjin po i kundërshton këto vlera edhe po i mohojka, mendoj që kjo është e gabueshme. Për sa i përket vlerave janë ekspertët e fushave të cilët bëjnë analizë dhe i shapllin ato monumente, bëjnë analiza të caktume për një zonë të caktume mu shpallë zonë e mbrojtur. Unë mendoj që në ata çka e thatë deri tash nuk mendoj që e arsyetoni zonën e veçantë për aq ma keq që projektligji në përmbajtjen e vetë, e kam parë projektligjin është një lloj imitimi për fshatin Hoçë e Madhe, kjo ua hap gojën atyre me thënë, na e dimë që edhe aty ka pasur trashëgimni kulturore objekte me vlera dhe në emër të asaj trashëgimnie ata kanë nxjerrë zonë të veçantë, pra kanë bërë keqpërdorim të trashëgimisë për motive etnike dhe politike, dhe pse duhet na mu perizie në çështjen e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe pse ne nuk jau lëjmë në mbrojtjen e trashëgimise kulturore ekspertëve. Unë mendoj se vetëm sa e përforcon logjikën e mbrapsht që vjen si rezultat i pakos së Ahtisarit, se kërkesë e nacionalizmit për me mujt me i ndërtu ata me bërë ndarje në vija etnike dhe ndarje në vija fetare atë pretendim që ne e kemi argumentu shumë drejt që po përzijn politikën në çështje që nuk kanë të drejt ta perziejn, çështje që kemi thënë në zhvillim rural të trashëgimisë kulturore, na e kemi mundë atë, dhe ata janë detyru me pru Hashim Thaqin dhe janë detyru me pru edhe Pieter Feithin me na bërë neve presion që me zor për me shti atë ligj dhe na tash motivin e tyre, argumentin tonë kryesor po e hedhim përmes këtij projektligji të fshatit Zym te Hasit.

Daut Haradinaj nuk është e vërtetë unë kam qenë atë ditë në sallë dhe presion askush nuk na ka bërë, e vërteta është tjetër që ju e keni lëshuar sallën kur është votuar.

Liburn Aliu ju e dini shumë mirë që ato projektligje njëhere nuk kan kaluar, dhe në fund kanë kaluar edhe e dimë se qysh.

Nait Hasani këtu jemi për me qu projektligjin në lexim të parë dhe se seanca është ajo që vendos për më tutje për këtë projektligj. Ne edhe herave të kaluara kemi pasë rast që jemi pajtuar për me e kthyer ndonjë Projektligj por që seanca i ka kthyer sërish dhe ne i kemi shqyrtuar prapë dhe i kemi ndryshu sa kemi mujt. Fjalën e ka Nijazi Idrizi.

Njazi Idrizi skemi nevojë me bo shumë debat se e kemi senacën, un e kam mirëpritur me dashamirësi propozimin e Dautit për këtë projektligj dhe madje mendoj që në Kosovë ka edhe vlera të tjera që duhet të merren parasysh dhe të trajtohen nga nismat e ndryshme dhe nuk është me rëndësi se kush e ndërrmer nismën. Do të ishte mire që keto nisma të trajtohen në një mënyrë tjetër por edhe kjo mënyrë është mënyra e duhur. Ky propozim është një profesionale dhe shumë dashamirëse për kulturën, traditën dhe për civilizimin tonë. Ky propozim nuk bie ndesh me propozimet që kanë qenë deri tash për mbrojtjen e monumenteve te kulturave dhe civilizimeve, kjo na qon kah ajo që ne kulturat dhe civilizimet i kemi të përbashkëta, ndaq le të jenë serbe, ndaq shqiptare, ndaq të kujdo qoftë ato janë vlera tona të cilat është mire ti mbrojmë. Kjo mënyrë që e ka zgjedhë edhe Dauti edhe të tjerët, jane te mira sepse ne kemi edhe shumë vende që kemi nevoj për ti mbrojtur! Unë e mirëpres dhe e mbeshtesë këtë nismë shumë të mirë!

Nait Hasani dikush tjetër, fjalën e ka Salih Morina.

Salih Morina këtë projektligj që e ka inicuar Dauti dhe ka pasur besim edhe te ne të tjerët megjithëse ka mbledhë edhe ni numër të nënshkrimeve për me iniciu sepse kërkohet ashtu me procedura. Në Ministrinë e Kulturës ku njëri prej departamenteve është edhe ai për trashëgimi kulturore dhe tash një qështje që edhe me kushtetutë trashëgimia duhet të jetë unike nuk duhet të jetë etnike megjithëse ka ndodhë me ato ligjet e pakos së Ahtisarit dhe ne e dimë si kanë qenë. Unë kisha kërku që tash Ligji për trashëgimi kulturore vjen diku ka nëntori sepse është në fazën përfundimtare që i mbronë të gjitha interesat e trashëgimisë kulturore pa dallim etnie, mirëpo kjo

është diqka e veçantë që e ka inicu Dauti dhe në këtë rast kisha kërku nga Dauti, që projektligji kur të vjen në seancë duhet me pasë një letër rekomandimi edhe nga komuna e Prizrenit me ditë se kush do ta implemetojë këtë Ligj e pranojnë ata apo se pranojnë. Siç tha edhe Dauti se tash këto komunat e reja që do ti bjen Rugovë apo Gjonaj nuk e di, por është mirë me pasë një letër rekomandimi nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, se a e merr përsipër me implemtu këtë Ligj deri sa të formohet komuna e re. Kjo ishte nën një dhe nën dy mirë kishte qenë që edhe nga Instituti i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore me marrë po ashtu një letërekomandimi për mi hjekë këto dilema se a përcakton etninë apo se përcakton dhe me pasë pak më lehtë deputetët në Pralament. **Nait Hasani** faleminderit dikush tjetër, pasi që nuk ka tjetër athëherë e qesim në votim se kush është për me përcjellë për seancë për lexim të parë. Me 5 vota për dhe 1 kundër, Komisioni i **rekomandon** seancës për miratim në parim të Projektligjit për fshatin Zymi i Hasit.

4. Raporti gjashtë mujor i punës së komisionit

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor gjatë periudhës janar –korrik 2013, ka mbajtur 24 mbledhje, 10 takime te grupeve punuese, 2 dëgjime publike; ka mbikëqyrë zbatimin e 2 ligjeve; ka realizuar 1 vizitë jashtë vendit dhe 4 brenda vendit; ka mbajtur me se 17 takime të ndryshme me delegacione të jashtme dhe ka shqyrtuar një raport të agjencive të pamvarura dhe një intervistë për zgjedhjen e drejtorit të agjencisë së pamvarur.

Komisioni, gjatë periudhës janar–korrik 2013, ka shqyrtuar 9 projektligje, për 6 prej tyre ka përfunduar amendamentimi si në vijim:

1. Projektligjin për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesës në Bashkëpronësi,
2. Projektligjin për Ujerrat e Kosovës,
3. Projektligjin për Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
4. Inspektorati i Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit,
5. Projektligjin për Planifikimit Hapësinor
6. Projektligjin për Blegtorinë,

Ndërsa 3 janë në shqyrtim dhe amendamentim e sipër:

7. Projektligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje,
8. Projektligjin për Kimikate,
9. Projektligjin për Fshatin Zymi i Hasit

Komisioni parlamentare, gjatë periudhës janar – korrik 2013, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve si në vijim:

1. Ligji nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndkimit në Mjedis,
2. Ligji nr. 03/L- 230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Komisioni, gjatë periudhës janar– korrik 2013, ka shqyrtuar raportin vjetor të organeve të pavarura, si në vijim:

1. Raporti vjetor i punës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizimi për vitin 2012

Komisioni, gjatë periudhës janar – korrik 2013, ka shqyrtuar:

1. Listën e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 10.40

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani